REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE

Nr 5541 prot Ballsh,më 22 / 10 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 61 Datë 22 / 10 2026

PËR
DHËNIEN E SHPËRBLIMEVE DHE PAGESËN E ORËVE SHTESË PËR PERSONELIN TË ANGAZHUAR NË SHUARJEN E ZJARREVE NË TERRITORIN E BASHKISË MALLAKASTËR.

Mbështetur në nenet 34,40,41, 55 të ligjit Nr 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore",ligjin Nr 9936 datë 26-08-2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",të ndryshuar,kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29,kreu VII nenet 39-40 të ligjit Nr 68/2017 "Për Financat e Vetqeverisjes Vendore",Ligjin Nr 87/2025"Për Buxhetin e Vitit 2026",ligjin Nr 10296 date 08-07-2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.51 datë 23.12.2025 "**Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 ,dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatmesëm 2026-2026 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve",** VKM nr. 613 datë 30.07.2026 "Për shpërblimin e personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2026",pika 2 e tij, dhe planit të veprimit të miratuar,kryetari i bashkisë i propozon këshillit bashkiak :.

TË MIRATOJ:

1. Dhënien e një page shpërblim për personelin e angazhuar në shuarjen e zjarreve për :
   1.1. Punonjësitë e policisë bashkiake – 10 efektivë
   1.2. Sektori mbrojtjes civile – 2 punonjës
   1.3. Drejtoria e shërbimit të pujeve dhe mjedisit – 5 punonjës
2. Pagesën e orëve shtesë të punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër,të angazhuar në shuarjen e zjarreve në territorin e Bashkisë Mallakastër.
3. Fondet për shpërblimin dhe pagesën e orëve shtesë do të mbulohen nga të ardhurat e veta të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër

Drejtor i drejtorisë Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
Aleksandër Rama

Drejtor i drejtorisë juridike dhe Çështjeve Sociale
Marjola Shehaj

KRYETAR

QERIM ISMAILAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALLAKASTËR